



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:070377

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06012374

KPPP.nr.432/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Nivelizim Ensari” SH.P.K., me NUI: 811446378, me seli në Lipjanë, Rruga “UÇK” fshati Shalë, kundër debitorit “Arseko” SH.P.K., me NUI: 810835233, me seli në Prishtinë, Rruga “Raif Pollomi” Mati 1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.53/24 të datës 30.01.2024, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Arseko” SH.P.K., ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejin e përbarimit P.nr.53/24 të datës 30.01.2024, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, për pjesën sa i përket detyrimit sipas Faturës Nr.7/23 në shumën prej 364.80 € (tre qind e gjashtëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë cent).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejin e përbarimit P.nr.53/24 të datës 30.01.2024, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, për pjesën e detyrimit kryesor sipas Faturës Nr.11/22 dhe Faturës Nr.2/23, në shumën prej 4,662.33 € (katër mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e dy euro e tridhjetë e tre cent), së bashku me kamatën ligjore sipas normës vjetore të interesit në lartësi prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “Nivelizim Ensari” SH.P.K., ndaj debitorit “Arseko” SH.P.K., sipas urdhrit përbarimor P.nr.53/24 të datës 30.01.2024, të Përbaruesit Destan Bujupaj, për shumën prej 364.80 € (tre qind e gjashtëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë cent).

- IV. URDHËROHET debitori “Arseko” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 4,662.33 € (katër mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e dy euro e tridhjetë e tre cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- V. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Nivelizim Ensari” SH.P.K., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.11/22 të datës 20.12.2022; Faturës Nr.2/23 të datës 21.03.2023 dhe Faturës Nr.7/23 të datës 26.12.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 5,027.13 € me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës, ashtu që përmbaruesi borxhin ta inkasoi me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat dhe pastaj në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se i njëjti është i pabazuar dhe në kundërshtim me. Sa i përket faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore ka deklaruar se të njëjtat nuk mund të jenë dokumente të përmbarueshëm, pasi që në këto fatura nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit, nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit. Tutje ka shtuar se kreditori nuk ka paraqit deklaratën me shkrim se kërkesa është bërë e arritshme. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se kundërshtimet e debitorit në prapësim, duke theksuar se debitori vetëm dëshiron ta zvarrisë procedurën përmbarimore pasi që po të mos ishin pranuar faturat i njëjti nuk do të realizonte

pagesa, përkatësisht debitori ka bërë pagese të pjesshme për faturën 11/2022 në shumë prej 2,000.00 €, me datë 30.12.2022, po ashtu kreditori vazhdimisht ka kërkuar përmbushjen e borxhit nga debitori. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetoi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.53/24 i datës 30.01.2024 duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 7/23 të datës 26.12.2023, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP - së.

Gjykata gjeti se dhe Fatura Nr. 7/23 e datës 26.12.2023, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se e njëjta është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar dhe as vulosur nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm - fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.53/24 të datës 30.01.2024 për shumën në vlerë prej 4,662.33 €, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të

besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr.11/22 të datës 20.12.2022 dhe Faturën Nr.2/23 të datës 21.03.2023, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekur i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, janë të përshtatshme për përmbartim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.432/22, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.